



Pranuar / Dostizna Priljena / Prilazno Received / Delivery	05 - 12 - 3 2023	viti god year	
Organ / Bësta Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHCK	7235/2023		119



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1310/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi, dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1310/2023 të datës 20.10.2023 të parashtruar nga me adrese banim rruga kundër

organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme/Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publik, në çështjen juridike “Kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 04.12.2023, mori këtë.

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.1310/2023 e datës 20.10.2023 e parashtruar nga ashtu që Shfuqizohet Vendimi me Nr.26/2023 i datës 19.09.2023 dhe Vendimi me Nr.169/2023 i datës 09.09.2023 të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në Departamentin e Menaxhimit të Zyrtarëve Publikë, dhe çështja kthehet në *rishqyrtim dhe rivendosje* te i njëjti organ.
- II. Obligohet Udhëheqësi i Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit, që të rishqyrtoj aplikacionin e ankueses brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Arsyetim

(tani e tutje referuar si *ankuesja*), kandidatë në procedurën e rekrutimit për grupin “Specialistë i Administrimit të Përgjithshëm”, respektivisht pozitën e punës “Inspektor i Tregut” në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, me datë 20.10.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 6622/2023 të regjistruar nën shenjen A.nr.1310/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokollit Nr. 26/2023 të

datës 19.09.2023 të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 23.10.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Punëve të Brendshme/Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publik, ndërsa me datë 25.10.2023, nga kjo e fundit ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.1310/2023 të datës 20.10.2023; Konkursi i datës 14.07.2023; Vendimi me numër protokoll Nr. 26/2023 i datës 19.09.2023 dhe Vendimi me numër protokoll Nr.169/2023 i datës 08.09.2023 të Udhëheqësit të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit; Lista e aplikuesve; Njoftimi i datës 11.09.2023; Njoftimi i datës 19.09.2023; Aplikacioni i me shkresat e bashkangjitura; Diplomë me numër protokoll 8111 e datës 24.08.2017; Diplomë me numër protokoll 928/45-65 e datës 29.07.2022; Vërtetim i datës 06.03.2017; Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 29.05.2015; Marrëveshje për angazhim e datës 29.11.2019; Akt Emërimi i datës 23.04.2021; Akt Emërimi i datës 01.09.2022; Dëshmi nga trusti për periudhën nga data 04.06.2021, deri me datën 27.07.2023; Akt Emërimi i datës 10.07.2023; Vërtetim i datës 07.08.2023; Certifikatë e datës 07.06.2023 mbi dënimet penale; Ankesë e datës 13.09.2023, drejtuar Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit; Përgjigje në ankesë e datës 25.10.2023, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e bashkangjitura të lëndës ka konstatuar se ankesa e ankueses është e bazuar dhe se lënda duhet të kthehet në *rishqyrtim dhe rivendosje* të organi i njëjtë, *sepse*:

Ministria e Punëve të Brendshme/Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë, me datë 14.07.2023 ka njoftuar për shpalljen e konkursin me numër Reference: RN00012073 për praninë për grupin "*Specialistë i Administrimit të Përgjithshëm*" për pozitën "*Inspektor i Tregut*" në kuadër të Inspektoratit të Tregut në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ku afati për aplikim ka qenë nga datë 04.08.2023 deri më datë 11.08.2023.

Sipas shkresave të lëndës në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja, ndërsa sipas Vendimit me Nr.169/2023 të datës 08.09.2023 të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit të njëjtës i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se nuk ka ofruar dëshmitë e kërkuara respektivisht kopjen e dëshmisë së trajnimeve të ndjekura apo trajnimeve që aplikuesi i ka realizuar në cilësinë e trajnuesit.

Ankuesja e pakënaqur me Vendimin me Nr.169/2023 të datës 08.09.2023, më datë 13.09.2023 ka parashtruar ankesë pranë Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në kuadër të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publik, ndërsa ky i fundit me Vendimin me Nr. 26/2023 të datës 19.09.2023 ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e ankueses me arsyetimin e njëjtë si në vendimin e kontestuar brenda organit përkatës.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.26/2023 të datës 19.09.2023 të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit, pretendon se ka plotësuar kushtet e konkursit për të kaluar fazën e verifikimit paraprak mirëpo organi përkatës i rekrutimit në kundërshtim me nenin 8 të Ligjit Nr.08/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe në mënyrë diskriminuese e ka eliminuar nga konkurrimi

me arsyetimin se e njëjta nuk ka dorëzuar dëshmi të trajnimeve të ndjekura apo trajnimeve që aplikuesi i ka realizuar në cilësinë e trajnuesit.

Kolegji i Këshillit, në kontekst të pretendimeve ankimore analizoi konkursin e shpallur dhe si rrjedhojë konstatoi se sipas Konkursit me numër Reference: RN00012073 për grupin Specialistë i Administrimit të Përgjithshëm, respektivisht për pozitën e punës "Inspektor i Tregut", kriteret e përgjithshme formale kanë qenë:

- *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve në fushat; Arsim i lartë i paspecifikuar.*
- *Përvoja e punës e kërkuar: Se paku (2) vite përvoja pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës;*

Rrjedhimisht, sipas klauzolës (pikës 7) të këtij konkursi si dokumente që duhet të dorëzohen me rastin e aplikimit kanë qenë të përcaktuara: *Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore, nostrifikimin apo aktin që dëshmon se diploma e marrë jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit; Kopjet e dëshmisë së punësimit të cilave u bashkëngjitet së paku njëra nga dëshmitë mbështetëse si në vijim: pasqyrën e pagesave në fondin e kursimeve pensionale, pasqyrën e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale (vërejtje nuk vlen vetëm vërtetimi dhe apo vetëm dokumenti mbështetës është i nevojshme ngarkimi në sistem i të dy llojeve të dokumenteve: vërtetimi si dëshmi kryesore dhe nja pasqyrat si dëshmi mbështetës; Nuk kërkohet dëshmi mbështetëse për përvojën e punës në sektorin publik; Kopjet e dëshmisë së trajnimeve të ndjekura apo trajnimeve që aplikuesi ka realizuar në cilësinë e trajnuesit. Njëra nga dokumentet është e nevojshme; Dëshmi përkatëse se kandidati/ja ka zotësi të plotë për të vepruar (prezantohet nga kandidati nëse ai/ajo përzgjidhet për emërim pas përfundimit të vlerësimit dhe në përputhje me rezultatin e arritur; Dëshmi mjekësore se kandidati/ja është në gjendje të mirë shëndetësore për kryerjen e detyrës (prezantohet nëse kandidati/ja përzgjidhet për emërim. Dëshmia duhet të jetë jo më e vjetër se gjatë muaj; Certifikatë/vërtetim nga gjykata ose Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kosovës me të cilën dëshmohet se nuk jeni dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje, jo më të vjetër se gjashtë muaj nga data e lëshimit; Nëse kohëzgjatja lidhur me përvojën e kërkuar të punës është në sektorin publik, atëherë është i nevojshme vërtetimi nga institucionit ku ka punuar kandidati/ja me të cilën dëshmohet se ai/ajo nuk ka ndonjë masë disiplinore në fuqi për largim nga një pozitë e zyrtarit publikë të pushuar sipas Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë; Nëse përvoja e punës e deklaruara është në sektori privat brenda apo jashtë vendit në një OJQ brenda apo jashtë vendit apo angazhimi nga i cili rrjedhë përvoja e punës është ndonjë formë e marrëdhënie kontraktuale që nuk nënkupton marrëdhënie pune, atëherë është i nevojshëm një vetë deklaram i nënshkruar se ai/ajo nuk ka një masë disiplinore në fuqi për largim nga një pozitë e zyrtarit publik të pushuar sipas Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.*

Kolegji i Këshillit, po ashtu në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore analizoi edhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, përkatësisht nenin 18 ku përcaktohet se: 1. *Kërkesat e përgjithshme formale janë kushte formale që duhet të plotësojë personi për të pasur të drejtën për të konkuruar në pranimin apo avancimin në karrierë në shërbimin civil. Plotësimi i këtyre kërkesave bën të supozohet se personi zotëron njohuritë, aftësitë dhe cilësitë bazike për kryerjen me sukses të detyrave të pozitës përkatëse.* 2. *Kërkesat e përgjithshme formale janë kërkesat për zotërimin e arsimit që përfshin nivelin dhe fushën e arsimit, kualifikimin apo certifikimin e posaçëm që kërkohet për atë pozitë përkatëse (psh. provinin e jurisprudencës apo ndonjë certifikim tjetër), përvojës profesionale domethënëse në profesion dhe/apo në punë apo kushteve të tjera specifike (psh. zotërimi një certifikimi për një gjuhë të huaj, etj.).* 3. *Përvoja profesionale dhe/apo menaxheriale llogaritet pas diplomimit në ciklin e parë të studimeve themelore.* 4. *Verifikimi i plotësimit të tyre në bazë të dokumentacionit të paraqitur apo vetë deklaramit të kandidatëve është hapi i parë, fazë e verifikimit paraprak në procedurën e*



pranimit apo ngritjes (avancimit) në karrierë në shërbimin civil të Kosovës, dhe si rrjedhojë Kolegji i Këshillit konstatoi se në konkursin e shpallur si kërkesa të përgjithshme formale nuk është përcaktuar ndonjë certifikim i posaçëm lidhur me vendin përkatës të punës, kështu që diskualifikimi i ankueses nga konkurrimi vetëm nga fakti se e njëjta nuk ka sjellë dëshmi mbi trajnimet e ndjekura nuk përbën shkak për refuzimin e aplikacionit të ankueses ngase një gjë e tillë bije në kundërshtim me kriteret e përgjithshme formale të përcaktuara në konkursin e shpallur.

Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit konstaton se në rrethanat e rastit konkret trajnimet ndërlidhen më fazën e vlerësimit të jetëshkrimit dhe vlerësohen në pajtim me nenin 22 paragrafi 4 nën paragrafi 4.3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kështu që për sa me sipër konstatohet se Vendimi me Nr.169/2023 i datës 08.09.2023 për refuzimin e aplikacionit dhe Vendimi me Nr.26/2023 i datës 19.09.2023 për refuzimin e ankesës të ankueses vetëm se e njëjta nuk ka sjellë dëshmi mbi trajnimet e ndjekura apo të realizuara në cilësinë e trajnuesit nuk janë në pajtueshmëri me dispozitat e ligjit material, respektivisht nenin 8 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe me vet kriteret e përcaktuara të konkursit, dhe se për këtë arsye aktet si me lart janë të paligjshme në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, andaj me qellim të kthimit të ligjshmërisë detyrohet Divizionin për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit pranë Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, që të rivlerësoj aplikacionin e ankueses në kuptim të pikëpamjeve si me lartë dhe vetëm pas eliminimit të shkeljeve të konstatuara të nxjerr vendim në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Kështu që për sa me sipër dhe duke u mbështetur në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr.1310/2023

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Jeton Koca

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.